



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	06.08.2025
REFERENC-Ë:	25/2024/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Flori" Sh.p.k. Bazë për prodhimin e betonit, Studençan, Suharekë.
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Flori" Sh.p.k. me Nr.Prot.25/2024/MMPHI, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e betonit, Studençan, Suharekë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/2204/MMPHI
Datë: 06.08.2025


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot. 25/2204/MMPHI e kompanisë "Flori" Sh.p.k. për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Bazë për prodhimin e betonit, në ngastrën kadastrale, nr.00739-0, zona kadastrale, Studençan, Suharekë.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/2204/MMPHI të kompanisë "Flori" Sh.p.k. për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e betonit, në ngastrën kadastrale, nr.00739-0, zona kadastrale, Studençan, Suharekë, MMPHI konstaton që operatori i ka **plotësuar** kushtet administrative dhe mjedisore për t'u pajisur me Leje Mjedisore.



Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810637134, datë:15.06.2007, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor, Nr.:19/2042/1-ZSP/327/19, datë:14.06.2019, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Leje Ujore për Shfrytëzim, Nr.: 403/23-ZSP-2023, datë: 30.01.2023;
- Leje Ujore për Shkarkim, Nr.: 404/23-ZSP-2023, datë: 30.01.2023;
- Leje për aktivitete të veçanta, 863/KPMM/2022, Nr.Prot.2927, datë: 02.09.2022, me kohëzgjatje deri më: 07.06.2027

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore dhe vizitës së realizuar në terren për verifikimin e kushteve mjedisore, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumentacionit si në vijim:

- Raportin e analizave të pluhurit total të depozituar;
- Pagesën e tarifës 70%


Operatori ka sjellë dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të lartëcekur.

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, merrë vendim që operatorit të lartëcekur t'i lëshohet Leja Mjedisore.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;



- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislationin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Suahrekë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.